



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:031002

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05587694

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.80/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në procedurën penale ndaj të pandehurit, D... I... nga Gjilani, të cilin sipas detyrës zyrtare avokate nga Gjilani, për shkak të veprave penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), dhe vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 196/2024 të datës 06.02.2024, pas mbajtjes së séances fillestare më datën 22.03.2024, publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit :D... I..., nga babai A... dhe nëna M..., me mbiemër të vajzërisë K..., i lindur me datë ..., në Gjilan, me vendbanim në rrugën lagjia Porodinit, në Gjilan, i pa punë, i pa martuar, gjendjen së varfër financiare, ka të kryer shkollën e mesme me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE

Më datë 25.Janar 2024, rreth orës 02.20 min, në objektin e Morgut të Spitalit Regjional në Gjilan, në rrugën në Gjilan, i pandehuri..., me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka tentuar që të kryej vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarës Spitalit Regjional në Gjilan, në atë mënyrë që fillimisht e thyen një karrigë dhe me pjesët e saja i thyen grilat e hekurin të dritares e më pas me përdorimin e forces e hap dritaren dhe hyn brenda në objekt ku duke kërkuar substancë demolon gjithë zyret mirëpo pasi që nuk

arrin që të gjejë, i njëjti largohet nga vendi i ngjarjes ,me ç'rast i pandehuri me veprimet e tij, të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale **Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.**

II.

Më datë 25.Janar 2024, rreth orës 05:00 min, në kioskun J... që ndodhet në rrugën “...” në Gjilan, i pandehuri, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka kryer vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarit Bujar Jakupi, në atë mënyrë që duke e përdorur forcën arrin që t'a hap roletën e kioskut dhe nga aty arrin që të marrë gjësende ushqimore në shumë prej 20 euro ,e më pas largohet nga vendi i ngjarjes me ç'rast i pandehuri me veprimet e tij, të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale **Vjedhje e rëndë nga neni 315, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipër theksuar ligjore dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPPK), të pandehurin Dorlir Ilazi e,

G J Y K O N

Për veprën penale si në **dispozitivin I** të këtij aktgjykimi **me dënim me gjobë në shumë prej 200(dyqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti e dy muaj,** ndërsa për veprën penale si në **dispozitivin II** të këtij aktgjykimi i shqipton dënim me burgim **në kohëzgjatje prej 1 (një) viti** , ashtu që të njëjtit duke u bazuar në nenin 76 paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.3, të KPRK-së, të pandehurit **i shqipton dënim UNIK** në kohëzgjatje prej 2 viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veper tjetër penale në periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20€ (njëzet euro), si dhe shumën prej nga 20€ (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.196/2024 të datës 06.02.2024, kundër të pandehuritnga Gjilani, për shkak të veprave penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur

me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), dhe vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së,

Në shqyrtimin fillestar të datës 22.03.2024, në të cilin ishin prezent Prokurorja e Shtetit, i pandehuri me mbrojtën e tij..., në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i njëjti ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilën akuzohet dhe se e pranonë fajësinë për kryerjen e veprës penale, pendohet për rastin që ka ndodhur dhe i kërkojnë falje njëri tjetrit. Po ashtu i dëmtuari ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi material.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores së shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, konform nenit 242 të KPPK-së, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri Dorlir Ilazi nga Gjilani, ka kryer veprat penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), dhe vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe gjykata të akuzuarit shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale ashtu që për të akuzuarit e lartcekur, si rrethanë lehtësuese e ka marrë faktin se të pandehurit kanë pranuar fajësinë, se të njëjtit janë penduar, të njëjtit i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejnë më vepër penale. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh dashjen e tyre për kryerjen e veprave penale dhe qëllimin e përfitimit të kundërligjshëm pasi që të dëmtuarin e kanë vëlla dhe i njëjti është deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi material.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me gjobë mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

9.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nënin 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit ti detyrojë për ti paguar shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor secili veç e veç në shumë prej nga 20€(njëzet euro), si dhe kompensimin prej nga 20€ (njëzet euro) për mbrojtjen e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.80/2024, me datë 22.03.2024

Gjyqtari,

Veli KRYEZIU

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.